




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA E KOSOVAR / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/OPK	Nr Prot. Prot No 01-3017/13
Nr. llog. Broj stranica 02	Data Datum 26-09-2013
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.09.2013, nxjerr këtë :

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-459/13, për z. Sokol Duraku, Auditor i brendshëm në Kompaninë Regjionale te Ujësjiellit Prishtina, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, pasi që zyrtari në fjalë nuk ushtron me funksion publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK–03-459/13 që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Sokol Duraku, Auditor i brendshëm në Kompaninë Regjionale të ujësjiellit Prishtina ku është dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e Funksionit Publik si, Auditor i brendshëm në Kompaninë Regjionale të ujësjiellit Prishtina, dhe angazhimit të tij në veprimtari tjera private si pronar dhe person i autorizuar në bizneset private me emër N.SH. “Univers Accounting” dhe N.P.T “New Fashion”.

Pas analizimit të gjendjes dhe prezantimeve të dokumenteve zyrtare nga pala z. Sokol Duraku është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit pasi që z. Sokol Duraku nuk është me duke e ushtruar pozitën e Auditorit të brendshëm në Kompaninë Regjionale të ujësjiellit Prishtina, dhe nuk e ka me statusin e zyrtarit të lartë publik sipas ligjit në fuqi, ky fakt dëshmon se nuk

kemi gjendje te konfliktit te Interesit dhe nuk kemi situatë qe dëshmon se ka shkelje të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrim e funksionit publik .

Andaj duke vlerësuar gjendjen faktike konstatojmë se nuk ka elemente qe dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit, pasi qe z. Sokol Duraku, nuk ushtron funksion publik dhe nuk e ka statusin e zyrtarit të lart

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

